



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 137

---

Tiranë – E premte, 22 korrik 2016

---

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 72/2016 datë 7.7.2016	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për shkëmbimin e informacionit për verifikimin e terrorizmit..... 11123
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 536, datë 22.7.2016	Për caktimin e ditës së hënë, datë 25 korrik, ditë pushimi..... 11126





**LIGJ**  
**Nr. 72/2016**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË  
SHTETEVE TË BASHKUARA TË  
AMERIKËS PËR SHKËMBIMIN E  
INFORMACIONIT PËR VERIFIKIMIN  
E TERRORIZMIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për shkëmbimin e informacionit për verifikimin e terrorizmit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 7.7.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9705, datë 16.7.2016  
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË  
SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS  
PËR SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT  
MBI VERIFIKIMIN E TERRORIZMIT**

**Preambulë**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (më poshtë të referuar individualisht si “Pala” dhe bashkërisht si “Palët”),

Të vendosur mbi përpjekjet e mëtejshme të përbashkëta dhe trajtimin e terrorizmit ndërkomëtar nëpërmjet bashkëpunimit në identifikimin e individëve që njihen ose dyshohen të jenë ose që

kanë qenë të përfshirë në veprimtari për përgatitjen, në ndihmë të ose që lidhen me terrorizmin ose veprimtari të terroriste, përfshirë shkëmbimin e informacionit verifikues që lidhet me personat terroristë të njohur ose të dyshuar, dhe

Me dëshirën për të krijuar procedura të përshtatshme për akses në, dhe për shkëmbimin e informacionit për verifikimin e terrorizmit në mënyrë që të forcojnë aftësinë e Palëve për t’u mbrojtur nga aktet e terrorizmit,

Pas arritjes së mirëkuptimit të mëposhtëm për të drejtuar bashkëpunimin e tyre në shkëmbimin dhe përdorimin e informacionit për verifikimin e terrorizmit.

**Neni 1**

**Përkufizimet**

Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. “Informacion paraprak” do të thotë informacion shtesë përveç informacionit për verifikimin e terrorizmit, i cili mund të përfshijë vendndodhjen e individit për verifikim, statusin e listës së të dyshuarve (si terroristë) ose nëse individit konsiderohet i rrezikshëm ose i armatosur.

2. “Informacion i pafavorshëm” do të thotë informacion zbulues ose informacion që përcakton natyrën e lidhjes së një individit me terrorizmin ose veprimtari të terroriste.

3. “Verifikim i individit” do të thotë çdo situatë në të cilën një individ identifikohet të ketë përputhje pozitive, përputhje potenciale ose përputhje jopërfundimtare me informacionin për verifikimin e terrorizmit, të mundësuar në zbatim të kësaj Marrëveshjeje.

4. “Palë ofruese” do të thotë, në lidhje me informacionin që është mundësuar ose që do të mundësohet sipas kësaj projekt marrëveshjeje ose qeveria e Shteteve të Bashkuara ose qeveria e Republikës së Shqipërisë, sipas rastit .

5. “Palë Marrëse” do të thotë, në lidhje me informacionin që është marrë ose që mund të merret sipas kësaj projekt marrëveshjeje ose qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ose qeveria e Republikës së Shqipërisë, sipas rastit.

6. “Agjencia përkatëse” do të thotë çdo agjenci qeveritare e autorizuar e një Pale, e cila mund të ketë zyrtarë të cilët kanë akses në informacionin e mundësuar sipas kësaj projekt marrëveshjeje ose mund të kërkohet në rastin e një verifikimi siç



përshkruhet në protokollin operacional të hartuar sipas nenit 4 të kësaj Marrëveshjeje, për të mundësuar informacionin shtesë ose për të marrë masa të tjera për të asistuar në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

7. “Informacion për verifikimin e terrorizmit” do të thotë informacion identiteti, i tillë si p.sh.: emri, data e lindjes, numri i pasaportës ose shtetësia/kombësia, pasaporta të vendit të origjinës, shtetësi/kombësi të mëparshme, apo elemente të tjerë specifik identifikimi në lidhje me terroristët e identifikuar ose të dyshuar.

#### Neni 2

### Qëllimi dhe fusha e shkëmbimit të informacionit

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është nxitja e shkëmbimit të informacionit për verifikimin e terrorizmit, me qëllimin e vetëm të rritjes së përpjekjeve efikase në luftën kundër terrorizmit.

2. Palët synojnë t'i sigurojnë njëra-tjetrës akses në informacionin për verifikimin e terrorizmit në pajtim me qëllimin dhe dispozitat e kësaj projekt marrëveshjeje dhe me protokollin operacional të hartuar në pajtim me nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje dhe në bazë të ligjeve dhe rregulloreve të brendshme të secilës Palë.

3. Qeveria e Republikës së Shqipërisë bie dakord që të mundësojë nëpërmjet Drejtorisë Antiterror në Policinë e Shtetit për qeverinë e Shteteve të Bashkuara akses në informacionin për verifikimin e terrorizmit.

4. Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës bie dakord që të mundësojë, nëpërmjet Qendrës së Verifikimit të Terroristëve (TSC) akses për Republikën e Shqipërisë në Informacionin për verifikimin e terrorizmit në gjuhën angleze.

5. Palët mund të shkëmbejnë informacion i pafavorshëm, nëse ka, nëpërmjet agjencive të tyre përkatëse sipas autoriteteve ekzistuese, marrëveshjeve ose rregulimeve. Asgjë në këtë projekt-marrëveshje nuk synohet për të kufizuar ose modifikuar ato instrumente apo shkëmbime.

6. Përveç shkëmbimit, riprodhimit, shpërndarjes reciproke e vazhdueshëm të informacionit për verifikimin e terrorizmit të parashtruar në këtë Marrëveshje. Qeveria e Republikës së Shqipërisë mund t'i ofrojë qeverisë së Shteteve të Bashkuara informacion mbi identitetin për të verifikuar informacionin mbi identitetin në lidhje me një

ngjarje të rëndësishme (p.sh., samite të rëndësishme politike ose ekonomike, gara të rëndësishme sportive) të zhvilluara në Republikën e Shqipërisë në mënyrë që të parandalojnë sulmet terroriste ose veprimtari të tjera që lidhen me terrorizmin në lidhje me ngjarjen e rëndësishme. Ky informacion mbi identitetin do të mundësohet për qeverinë e Shteteve të Bashkuara në një mënyrë që do të vendoset nga Palët.

Informacioni i shkëmbyer sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të kompromentojë apo ekspozojë burimin e informacionit. Asnjë nga palët ofruese nuk është e detyruar të japë burimin e informacionit.

#### Neni 3

### Procedurat për shkëmbimin e informacionit

1. Me qëllim zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, secila Palë do të caktojë një ose më shumë pika kontakti. Për qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës pika e kontaktit është Qendra e Verifikimit të Terroristëve. Për qeverinë e Republikës së Shqipërisë, pika e kontaktit do të jetë Drejtoria Antiterror në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Pikat e kontaktit do të merren me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje., Secila Palë do të njoftojë Palën tjetër për këto emërime në komunikime të veçanta me shkrim.

2. Brenda 30 ditëve që pas datës kur kjo Marrëveshjeje hyn në fuqi, pikat e kontaktit synojnë të diskutojnë në lidhje me mënyrën sesi do të shkëmbehen të dhënat dhe mund të vendosin që këto procedura të bëhen me shkrim.

#### Neni 4

### Protokollet operacionale

Pikat e kontaktit do të përgatisin një protokoll operacional për të përcaktuar kategoritë e individëve që do të përfshihen në informacionin për verifikimin e terrorizmit për t'u siguruar nga secila Palë sipas kësaj projekt marrëveshjeje dhe për të krijuar procedurat që do të zbatohen në rast se Pala Marrëse apo një agjenci përkatëse zbulon një individ, i cili përputhet potencialisht me informacionin e verifikimit të terrorizmit nga Pala Siguruese.

#### Neni 5

### Përdorimi dhe mbrojtja e informacionit

1. Secila Palë do të përditësojë dhe korrigjojë brenda një kohe të shpejtë informacionin e



shkëmbyer sipas kësaj Marrëveshje. Secila Palë do të përdorë, në masën më të madhe të mundshme, informacionin më të fundit që merr nga Pala tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje.

2. Pala Marrëse do të kufizojë aksesin në informacionin që merr nga Pala Ofruese sipas kësaj Marrëveshjes vetëm për personelin e tij ku personi i autorizuar që ka informacionin kërkon të ketë akses në informacionin specifik, në mënyrë që të kryejë ose të asistojë në një funksion të ligjshëm dhe të autorizuar qeveritar në lidhje me qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

3. Nëse Pala Ofruese nuk jep miratim me shkrim, çdo zbulim i informacionit të marrë sipas kësaj Marrëveshjeje duhet të ndalohej, duke përfshirë:

a) përdorimin në çdo procedurë ose proces ligjor, ose administrativ, ose në çdo proces gjyqësor, ose në çdo proces që mund të rezultojë në zbulim publik;

b) zbulimin e informacionit te një qeveri e huaj palë e tretë;

c) zbulimin e informacionit te një organizatë ndërkombëtare;

d) zbulimin e informacionit te palët private, duke përfshirë subjektin e informacionit për verifikimin e terrorizmit (pavarësisht nëse Pala përputhet me subjektin); dhe

e) zbulimin e çdo informacioni në lidhje me faktin nëse një individ është jo subjekt i informacionit për verifikimin e terrorizmit të mundësuar sipas kësaj Marrëveshjeje.

4. Subjekti i ligjeve, rregulloreve dhe politikave kombëtare të Palëve çdo riprodhim, shpërndarje apo komunikim të çdo informacioni të mundësuar nga Palët sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç emrit, datëlindjes, numrit të pasaportës, pasaportës së vendit të origjinës apo kombësisë/shtetësisë aktuale apo të mëparshme, duhet të shoqërohet me një deklaratë e cila përshkruan përdorimin dhe kufizimet e zbulimit të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 3, të kësaj Marrëveshjeje.

5. Informacioni i shkëmbyer sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të kompromentojë apo ekspozojë burimin e informacionit. Asnjë nga palët ofruese nuk është e detyruar të japë burimin e informacionit.”

6. Çdo kërkesë nga Pala Marrëse për miratimin për zbulim të informacionit, i cili ndryshe ndalohej sipas kësaj Marrëveshjeje, do të koordinohet

nëpërmjet pikës së kontaktit të Palës Ofruese.

7. Palët do të konsultohen mbi çdo paqartësi apo pyetje në lidhje me autorizimin e zbulimit të informacionit sipas kësaj projekt marrëveshjeje dhe Palët priten që ta zgjidhin çështjen në favor të mbrojtjes së informacionit.

8. Në rast se kjo Marrëveshje përfundon, secila palë do të asgjësojë të gjithë informacionin e marrë sipas kësaj Marrëveshjeje, në një masë të mundshme, në rast se nuk vendoset ndryshe nga Palët me shkrim; ose nëse një asgjësim i tillë do të ishte në kundërshtim me kërkesat për ruajtjen e të dhënave të Palëve. Çdo Palë do të përdorë procedurat e saj më të rrepta të mundshme sipas ligjeve të tyre të brendshme përkatëse për asgjësimin e çdo informacioni të mundësuar sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

#### **Siguria e informacionit**

1. Çdo Palë do të përdorë masat mbrojtëse të përshtatshme administrative teknike dhe të sigurisë fizike për të kontrolluar aksesin në informacionin e marrë sipas kësaj Marrëveshjeje dhe në çdo kohë për të ruajtur këtë informacion në një sistem të sigurt elektronik ruajtjeje në përputhje me ligjin e saj të brendshëm. Informacioni i prodhuar sipas kësaj Marrëveshjeje do të klasifikohet sipas ligjeve kombëtare, rregullave dhe politikave të shteteve respektive.

2. Çdo palë do të monitorojë zbatimin përkatës të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje që i përket mbrojtjes së informacionit dhe do të konsultohet me palën tjetër sipas rastit, në lidhje me çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes.

3. Çdo palë bën përpjekjet maksimale që të sigurojë se i gjithë personeli me akses në informacionin e marrë sipas kësaj Marrëveshjeje, të jetë i pajisur me certifikatë sigurie përshtatshme me nivelin e informacionit që do të përfitohet, si dhe të jetë i trajnuar me masat mbrojtëse që kërkohen për të mbrojtur informacionin e dhënë nga tjetri. Çdo palë do të raportojë te pala tjetër çdo përpjekje për të pasur akses të paautorizuar apo për të përdorur në mënyrë të paautorizuar apo për të zbuluar informacionin e dhënë nga tjetri.



### Neni 7 Korrigjimet

1. Çdo palë do të ketë apo do të vendosë procedurat për individët për të regjistruar ankesat e lidhura me informacionin e mundësuar sipas kësaj Marrëveshjeje për të ndihmuar në zgjidhjen e mundshme të keqidentifikimeve.

2. Nëse pala merr një ankesë sipas këtyre procedurave, pala do t'i sigurojë një kopje pikës së kontaktit të palës tjetër dhe të këshillohet, sipas rastit, në përputhje me të gjitha masat që do të merren.

3. Kur është e mundur, pala ofruese do të bëjë korrigjimet e nevojshme.

4. Palët nuk do të zbulojnë tek askush (duke përfshirë edhe personin që paraqet ankesën) faktin se një kopje e ankesës i është dërguar palës tjetër apo lidhet me ndonjë informacion të mundësuar nga pala tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje.

### Neni 8 Konsultimi

Palët priten të konsultohen rregullisht nëpërmjet pikave të tyre të kontaktit për të zbatuar këtë Marrëveshje dhe për të zgjidhur mosmarrëveshjet, nëse do të jetë e nevojshme.

### Neni 9 Marrëdhënia me Marrëveshje dhe rregullime të tjera

1. Të drejtat dhe detyrimet e palëve sipas kësaj Marrëveshjeje do të sigurohen dhe do të përmbushen në masën e lejuar nga ligjet dhe rregulloret e brendshme të secilës palë. Kjo Marrëveshjeje nuk do të prekë apo kufizojë ndonjë marrëveshjeje apo rregullimin ndërmjet palëve, duke përfshirë marrëveshjet apo rregullimet në lidhje me zbatimin e ligjit, shkëmbimin e informacionit ose përpjekjet për luftën kundër terrorizmit.

2. Asgjë në këtë Marrëveshjeje nuk do të sigurojë një të drejtë private për të filluar procedim kundër secilës palë.

### Neni 10 Rregullimet financiare

Secila palë do të jetë përgjegjëse për kostot dhe shpenzimet që shkakton në lidhje me përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme. Të

gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje janë subjekt i disponueshmërisë së fondeve të përshtatshme të autorizuara për këto qëllime.

### Neni 11 Ndryshimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me miratimin me shkrim të Palëve.

### Neni 12 Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshjeje do të hyjë në fuqi nga data e marrjes nëpërmjet kanaleve diplomatike të njoftimit të fundit me shkrim mbi përmbushjen nga palët të procedurave të tyre të brendshme të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

2. Çdo palë mund t'i japë fund kësaj Marrëveshjeje duke dhënë një njoftim 6 (gjashtë) muaj para, duke i dërguar një njoftim me shkrim palës tjetër. Të gjitha përgjegjësitë dhe mirëkuptimet në lidhje me përdorimin dhe zbulimin e informacionit të marrë sipas kësaj Marrëveshjeje, para përfundimit të kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojë edhe pas kësaj ndërprejeje.

E nënshkruar në Washington D.C., sot, më 14 prill 2016, në dy kopje identike, në gjuhën shqipe dhe angleze, ku të dyja tekstet janë njëloj autentike.

### VENDIM Nr. 536, datë 22.7.2016

### PËR CAKTIMIN E DITËS SË HËNË, DATË 25 KORRIK, DITË PUSHIMI

Në mbështetje të neneve 95, pika 2, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Caktimin e ditës së hënë, datë 25 korrik 2016, ditë pushimi për punonjësit e administratës shtetërore.

2. Ngarkohen institucionet e administratës shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama



	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2016

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 56 lekë